

UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA

PAKETA E INSTRUMENTEVE TË CILËSISË *Instrumente për vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike dhe administrative*

NJËSIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË Qershor, 2025

Dr. Nikolla Nika -Kryetar, Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës

Prof. Asoc. Dr. Aranit Shkurti – Anëtar, Fakulteti i Ekonomisë

Msc. Virtyt Lesha – Anëtar, Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT

Prof. Asoc. Dr. Vita Koja – Anëtare, Përfaqësuese e Adminsitratës

Prof. Asoc. Dr. Ramadan Çipuri – Anëtar, Ekspert i Jashtëm

Mateo Hysa- Anëtar, Kryetari i Këshillit Studentor

Adresa: Rruga “Sotir Kolea”, Qyteti Studenti, Tiranë | Shqipëri

Kontakti: njsbc@umt.edu.al, +355 69 60 09 938, +355 69 25 291 493

Faqja e internetit: iqau.umd.edu.al

PËRMBAJTJA

INSTRUMENTET E CILËSISË PËR VLERËSIMIN INSTITUCIONAL	3
SISTEMI I VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS NË UNIVERSITETIN METROPOLITAN TIRANA...	3
FORMULAR PËR VLERËSIMIN E INSTITUCIONIT NGA ANËTARËT E PERSONELIT AKADEMIK.	7
FORMULAR PËR VLERËSIMIN E INSTITUCIONIT NGA ANËTARËT E PERSONELIT ADMINISTRATIV	11
FORMULAR PËR VLERËSIMIN E INSTITUCIONIT NGA STUDENTËT.....	11
FORMULAR PËR VLERËSIMIN E PËRVOJËS SË STUDENTËVE TË VITIT TË PARË NË UMT	19
FORMULAR PËR VLERËSIMIN E REKTORIT NGA SENATI AKADEMIK	23
FORMULAR PËR VLERËSIMIN E ZËVENDËSREKTORIT/ËVE NGA ANËTARËT E SENATIT AKADEMIK	25
FORMULAR PËR VETËVLERËSIMIN E ZËVENDËSREKTORIT/ËVE	27
FORMULAR PËR VLERËSIMIN E ZËVENDËSREKTORIT/ËVE NGA REKTORI	30
FORMULAR PËR VLERËSIMIN E PERFORMANCËS SË DEKANIT NGA STAFI AKADEMIK I FAKULTETIT.....	32
FORMULAR PËR VETËVLERËSIMIN E DEKANIT	34
FORMULAR PËR VLERËSIMIN E PERFORMANCËS SË DEKANIT NGA REKTORI.....	37
FORMULAR PËR VLERËSIMIN E PËRGJEGJËSIT TË DEPARTAMENTIT NGA STAFI AKADEMIK	39
FORMULAR VETËVLERËSIMI PËR PËRGJEGJËSIN E DEPARTAMENTIT	41
FORMULAR PËR VLERËSIMIN E PËRGJEGJËSIT TË DEPARTAMENTIT NGA DEKANI	44
FORMULARI I VLERËSIMIT TË PEDAGOGUT NGA STUDENTËT	46
FORMULAR PËR VLERËSIMIN E PERSONELIT AKADEMIK NGA KOLEGËT	48
FORMULARI I VLERËSIMIT TË LËNDËS NGA STUDENTËT	50
FORMULAR PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT NGA STUDENTËT NË PRAG DIPLOMIMI	52
FORMULAR I REALIZIMIT TË VEPRIMTARISË SË PESONELIT AKADEMIK NË UMT.....	54

INSTRUMENTET E CILËSISË PËR VLERËSIMIN INSTITUCIONAL

Sigurimi i cilësisë është një proces i vazhdueshëm dhe shumëdimensional, i cili ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin institucional dhe në arritjen e standardeve të larta akademike. Në Universitetin Metropolitan Tirana (UMT), vlerësimi i cilësisë shtrihet në të gjitha aspektet e funksionimit të institucionit, duke u bazuar në metodologji të strukturuar dhe instrumente të specializuara për të siguruar një analizë objektive dhe gjithëpërfshirëse.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) ka zhvilluar mekanizma të dedikuar për të mbledhur dhe analizuar të dhëna nga të gjithë aktorët kryesorë të institucionit, përfshirë:

- Vlerësimin institucional nga stafi akademik
- Vlerësimin institucional nga stafi administrativ
- Vlerësimin institucional nga studentët
- Vlerësimi i përvojës së studentëve të vitit të parë në fillim të studimeve.

Këto procese kryhen në mënyrë periodike dhe bazohen në pyetësorë të hartuar sipas standardeve më të mira të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Përmes analizës së të dhënave të mbledhura, UMT synon të identifikojë pikat e forta, sfidat dhe mundësitë për përmirësim, duke krijuar kështu një kulturë institucionale të bazuar në vlerësimin objektiv dhe në transparencën e rezultateve.

Përveç vlerësimeve të rregullta vjetore, NJSBC harton edhe raporte të detajuara mbi performancën akademike dhe administrative, të cilat përpunohen dhe prezantohen në tre nivele:

- Në nivel të njësive bazë
- Në nivel të njësive kryesore
- Në nivel institucional

Ky sistem i vlerësimit siguron që çdo vendimarrje mbi përmirësimin e cilësisë në UMT të jetë e mbështetur në të dhëna konkrete dhe në analiza të detajuara. Duke garantuar një cikël të qëndrueshëm të vlerësimit dhe përmirësimit, universiteti synon jo vetëm të ruajë standardet ekzistuese, por edhe të zhvillohet në përputhje me praktikatat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare në arsimin e lartë.

SISTEMI I VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS NË UNIVERSITETIN METROPOLITAN TIRANA

Performanca e stafit akademik dhe administrativ është një faktor kyç për funksionimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Universitetit Metropolitan Tirana (UMT). Për këtë arsye, vlerësimi i performancës është integruar si një proces i vazhdueshëm, i bazuar në standarde të qarta dhe mekanizma të besueshëm matës.

Ky sistem siguron që vlerësimi të mos jetë thjesht një mjet monitorimi, por një instrument për rritjen profesionale dhe përmirësimin e efektivitetit të përgjithshëm të institucionit.

Në këtë kontekst, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) ka zhvilluar një qasje gjithëpërfshirëse që kombinon vetëvlerësimin me vlerësimin nga palët e treta, duke krijuar një model të ekuilibruar të analizës së performancës. Ky sistem synon jo vetëm të matë përmbushjen e objektivave të institucionit, por edhe të mbështesë zhvillimin individual të çdo anëtari të stafit.

Komponentët kryesorë të sistemit të vlerësimit të performancës

- **Vlerësimi i performancës akademike** – Ky proces përfshin analiza të hollësishme mbi metodat e mësimdhënies, angazhimin në kërkimin shkencor dhe kontributin në zhvillimin e programeve studimore. Përveç matjeve të bazuara në kritere standarde, vlerësimi merr parasysh edhe inovacionin pedagogjik dhe cilësinë e ndërveprimit me studentët.
- **Vlerësimi i performancës administrative** – Efikasiteti i administratës është i domosdoshëm për funksionimin e universitetit. Për këtë arsye, sistemi i vlerësimit analizon jo vetëm përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi, por edhe aftësinë për të ofruar mbështetje efektive ndaj komunitetit akademik.
- **Vetëvlerësimi dhe vlerësimi nga kolegët** – Për të garantuar një proces vlerësimi të balancuar, çdo anëtar i stafit ka mundësinë të reflektojë mbi performancën e tij, ndërkohë që vlerësimet nga kolegët ndihmojnë në krijimin e një pasqyre më të gjerë mbi kontributin individual dhe grupor.
- **Përdorimi i të dhënave për përmirësim strategjik** – Rezultatet e vlerësimit nuk mbeten vetëm në nivel raportimi, por shërbejnë si bazë për vendimmarrjen institucionale. Përmes analizave të hollësishme, NJSBC identifikon nevojat për zhvillim profesional dhe fushat ku mund të ndërhyhet për të rritur efektivitetin institucional.

Ky sistem vlerësimi synon të krijojë një kulturë institucionale të bazuar në meritokraci, profesionalizëm dhe përmirësim të vazhdueshëm, duke kontribuar në përforcimin e rolit të UMT si një institucion i orientuar drejt ekselencës akademike dhe menaxheriale.

Kategoritë dhe instrumentet e vlerësimit të performancës

Sistemi i vlerësimit të performancës në Universitetin Metropolitan Tirana (UMT) është i ndërtuar mbi një strukturë të diferencuar, e cila synon të ofrojë një analizë të plotë dhe të balancuar mbi efektivitetin dhe kontributin e stafit akademik dhe administrativ. Ky proces vlerësimi përfshin kategori specifike në përputhje me rolet dhe përgjegjësitë e secilit nivel institucional, duke siguruar një qasje gjithëpërfshirëse që reflekton realitetin akademik dhe organizativ të universitetit.

1. Vlerësimi i performancës së Rektorit

- Vlerësimi nga anëtarët e Senatit Akademik mbi drejtimin strategjik dhe menaxhimin institucional.

2. Vlerësimi i performancës së Zëvendësrektorit

- Vlerësimi nga anëtarët e Senatit Akademik
- Vetëvlerësimi
- Vlerësimi nga Rektori

3. Vlerësimi i performancës së Dekanit

- Vlerësimi nga stafi akademik i fakultetit
- Vetëvlerësimi
- Vlerësimi nga Rektori

4. Vlerësimi i performancës së Përgjegjësit të Departamentit

- Vlerësimi nga stafi akademik i departamentit
- Vetëvlerësimi
- Vlerësimi nga Dekani

6. Vlerësimi i performancës së pedagogëve

- Vlerësimi nga studentët për performancën në çdo lëndë që ata drejtojnë
- Vlerësimi nga kolegët për bashkëpunimin dhe komunikimin profesional
- Vetëvlerësimi
- Vlerësimi i leksioneve të hapura
- Raportim mbi realizimin e veprimtarisë në UMT

Vlerësimi i programeve të studimit

- Vlerësimin e çdo lënde nga studentët
- Vlerësimin e programit të studimit nga studentët në përfundim të ciklit të studimeve
- Vlerësimin nga të diplomuarit (alumni) e punësuar
- Vlerësimin nga punëdhënësit mbi aftësitë dhe njohuritë profesionale të punëmarrësve të diplomuar nga programet e studimit në UMT

Instrumentet për zhvillimin profesional dhe trajnime

Paketa përfshin gjithashtu pyetësorë mbi:

- Nevojat për zhvillim profesional të personelit akademik dhe administrativ;
- Vlerësimin e programeve të trajnimit të realizuara.

Sistemi i vlerësimit të performancës në Universitetin Metropolitan Tirana (UMT) është konceptuar si një mekanizëm i hapur dhe i adaptueshëm, i cili evoluon në përputhje me ndryshimet e brendshme institucionale dhe zhvillimet më të fundit në fushën e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Ky fleksibilitet siguron që vlerësimi të mos mbetet një proces statik, por të përmirësohet vazhdimisht për të reflektuar realitetet dhe nevojat e universitetit.

Rishikimi periodik i instrumenteve të vlerësimit mundëson identifikimin e aspekteve që kërkojnë optimizim, duke garantuar që mekanizmat e matjes së performancës të jenë gjithmonë të përshtatur me objektivat strategjike të institucionit. Në këtë mënyrë, universiteti siguron që vlerësimi të mos jetë thjesht një formalitet administrativ, por një mjet efektiv për rritjen e cilësisë akademike dhe institucionale.

Përmes kësaj qasjeje dinamike, UMT synon të ruajë standardet e larta akademike, të nxisë një kulturë të përmirësimit të vazhdueshëm dhe të krijojë një mjedis stimulues për zhvillimin profesional të stafit dhe për përvojën akademike të studentëve.

PYETËSOR PËR VLERËSIMIN E INSTITUCIONIT NGA ANËTARËT E PERSONELIT AKADEMIK

I nderuar anëtar i personelit akademik,

Ky pyetësor synon të ofrojë një hapësirë për të shprehur vlerësimin tuaj mbi përvojën në Universitetin Metropolitan Tirana (UMT), duke na ndihmuar të identifikojmë fushat ku mund të përmirësojmë më tej mbështetjen dhe zhvillimin profesional për stafin tonë akademik.

Rezultatet e këtij pyetësori do të shërbejnë për të nxitur një mjedis akademik që reflekton standardet dhe aspiratat e larta të institucionit tonë. Përgjigjet tuaja do të trajtohen me konfidencialitet të plotë dhe do të ndihmojnë në zhvillimin e një vizioni më të qartë për përmirësimin e përvojës së përbashkët në UMT.

Ju falënderojmë për kohën, singjeritetin dhe angazhimin tuaj të vazhdueshëm në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit në institucionin tonë!

Kategoria së cilës i përkisni

- A. Profesor
- B. Lektor
- C. Asistent lektor

Eksperienca e punës

- A. 1-5 vjet
- B. 6-10 vjet
- C. 11-15 vjet
- D. 16-20 vjet
- E. Mbi 20 vjet

Vlerësoni pohimet e mëposhtme sipas shkallës nga 1 në 5, ku 1 është vlerësim minimal dhe 5 maksimal, respektivisht nga “Nuk jam aspak dakord” deri në “Jam plotësisht dakord”.

<i>Infrastruktura fizike dhe teknologjike e institucionit</i>						
Nr.	Pohimi	Vlerësimi				
1	Pastërtia dhe mirëmbajtja e mjediseve të përbashkëta janë në përputhje me standardet institucionale të higjienës	1	2	3	4	5
2	Jam i kënaqur me nivelin e sigurisë fizike dhe të mbrojtjes që institucioni ofron	1	2	3	4	5
3	Shërbimet mjekësore dhe ndihma e parë e ofruar në institucion janë në nivelin e duhur	1	2	3	4	5

4	Hapësira që kam në vendin e punës dhe mësimdhënies është e mjaftueshme dhe motivuese për punë efektive	1	2	3	4	5
5	Institucioni ofron një infrastrukturë teknologjike bashkëkohore (si projektorë, kompjuterë, rrjet interneti, sistem i menaxhimit të informacionit) që lehtëson mësimdhënien dhe kërkimin	1	2	3	4	5
6	Numri i studentëve në klasa lejon zhvillimin normal dhe efektiv të mësimin	1	2	3	4	5
7	Institucioni ofron mundësi të përshtatshme për shërbime sociale (si kafene, ngrënie e drekës, mjedise sportive etj.) që lehtësojnë komoditetin dhe mirëqenien gjatë orarit të punës	1	2	3	4	5
<i>Roli dhe të drejtat e personelit akademik në institucion</i>						
8	Kam përshkrim të qartë të detyrave që më përkasin	1	2	3	4	5
9	Institucioni respekton kushtet kontraktuale lidhur me angazhimin tim	1	2	3	4	5
10	Procedurat për adresimin e ankesave janë të aksesueshme	1	2	3	4	5
11	Procesi i vlerësimit të performancës akademike është i qartë, transparent dhe i bazuar në kriteret objektive	1	2	3	4	5
12	Personeli akademik gëzon liri në shprehjen e mendimeve dhe qëndrimeve të tij	1	2	3	4	5
13	Institucioni mbështet dhe inkurajon idetë dhe kontributet e reja nga personeli akademik	1	2	3	4	5
14	Institucioni nxit përfshirjen e personelit akademik në proceset vendimmarrëse	1	2	3	4	5
15	Detyrat e mia janë në përputhje me fushën time akademike	1	2	3	4	5
16	Jam i kënaqur me balancën ndërmjet kërkimit shkencor, mësimdhënies dhe shërbimit ndaj komunitetit	1	2	3	4	5
17	Përfshirja ime në detyra administrative ndikon në kohën dhe energjinë që mund t'i përkushtoj angazhimeve akademike	1	2	3	4	5
<i>Shërbimet dhe mbështetja akademike e institucionit</i>						
18	Institucioni më ofron mbështetjen administrative të nevojshme për përmbushjen e detyrave të mia	1	2	3	4	5
19	Numri i personelit administrativ është i mjaftueshëm për të mbështetur nevojat e institucionit	1	2	3	4	5
20	Jam i kënaqur me efektivitetin e punës së sekretarisë së njësive përkatëse	1	2	3	4	5

21	Institucioni ofron një mjedis pune të qëndrueshëm dhe siguri për vazhdimësinë e angazhimit tim akademik	1	2	3	4	5
22	Jam i kënaqur me atmosferën e përgjithshme të punës në institucion	1	2	3	4	5
23	Kam një bashkëpunim konstruktiv dhe të kënaqshëm me kolegët	1	2	3	4	5
24	Institucioni i kushton rëndësi dhe përdor me efikasitet ekspertizën profesionale të personelit akademik	1	2	3	4	5
25	Institucioni ofron mbështetje për pjesëmarrjen e personelit akademik në veprimtari akademike (konferenca shkencore, publikime në revista të rëndësishme, etj.)	1	2	3	4	5
26	Institucioni siguron burime dhe infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e kërkimit shkencor brenda institucionit	1	2	3	4	5
27	U kushtohet rëndësi e mjaftueshme programeve të shkëmbimit për personelin akademik dhe studentët	1	2	3	4	5
28	Institucioni u siguron studentëve akses të lehtë dhe të mjaftueshëm për komunikim me stafin akademik	1	2	3	4	5
29	Jam i kënaqur me nivelin akademik dhe përkushtimin e studentëve në procesin e mësimdhënies	1	2	3	4	5
<i>Vizioni dhe strategjia institucionale</i>						
30	Jam në dijeni për vizionin dhe misionin e institucionit	1	2	3	4	5
31	Programet e studimit të ofruara nga institucioni përputhen me interesat dhe nevojat kombëtare	1	2	3	4	5
32	Institucioni drejtohet me profesionalizëm dhe integritet	1	2	3	4	5
33	Institucioni i kushton rëndësi të veçantë prezantimit kombëtar dhe ndërkombëtar	1	2	3	4	5
34	E shoh UMT si një institucion të qëndrueshëm ku mund të zhvilloj karrierën time akademike afatgjatë	1	2	3	4	5
35	E sugjeroj UMT si një mundësi të shkëlqyer për zhvillimin e karrierës akademike	1	2	3	4	5
36	Kushtet financiare të ofruara nga institucioni janë të kënaqshme	1	2	3	4	5
37	Institucioni inkurajon përfshirjen e personelit akademik në zhvillimin dhe përmirësimin e strategjive të tij afatgjata	1	2	3	4	5

1. Rendisni disa nga aspektet kryesore në UMT që ju japin kënaqësi në punën tuaj

2. Përmendni disa elemente që, sipas mendimit tuaj, do të ndihmonin në rritjen e motivimit tuaj në UMT

3. Rendisni një ose disa faktorë që mund t'ju motivojnë për të kërkuar mundësi të reja karriere jashtë UMT.

4. Sugjeroni çfarë mund të ndryshohet ose përmirësohet për të arritur një administrim më të mirë në UMT.

PYETËSOR PËR VLERËSIMIN E INSTITUCIONIT NGA ANËTARËT E PERSONELIT ADMINISTRATIV

I nderuar anëtar i personelit administrativ,

Ky pyetësor synon të ofrojë një hapësirë për të shprehur vlerësimin tuaj mbi përvojën në Universitetin Metropolitan Tirana (UMT), duke na ndihmuar të identifikojmë fushat ku mund të përmirësojmë më tej mbështetjen dhe zhvillimin profesional për stafin tonë administrativ.

Rezultatet e këtij pyetësori do të shërbejnë për të nxitur një mjedis pune që reflekton standardet dhe aspiratat e larta të institucionit tonë. Përgjigjet tuaja do të trajtohen me konfidencialitet të plotë dhe do të ndihmojnë në zhvillimin e një vizioni më të qartë për përmirësimin e përvojës së përbashkët në UMT.

Ju falënderojmë për kohën, sinjeritetin dhe angazhimin tuaj të vazhdueshëm në përmirësimin e shërbimeve dhe mbështetjes për funksionimin e suksesshëm të institucionit tonë!

Pozicioni

- D. Drejtues njësie/zyre
- E. Specialist

Gjinia

- A. Femër
- B. Mashkull

Eksperiencia e punës

- F. 1-5
- G. 6-10
- H. 11-15
- I. 16-20
- J. Mbi 20

Vlerësoni pohimet e mëposhtme sipas shkallës nga 1 në 5, ku 1 është vlerësim minimal dhe 5 maksimal, respektivisht nga “Nuk jam aspak dakord” deri në “Jam plotësisht dakord”.

Nr.	Pohimi	Vlerësimi				
Infrastruktura fizike dhe teknologjike e institucionit						
1	Pastërtia dhe mirëmbajtja e mjediseve të përbashkëta janë në përputhje me standardet institucionale të higjienës	1	2	3	4	5
2	Jam i kënaqur me nivelin e sigurisë fizike dhe të mbrojtjes që institucioni ofron	1	2	3	4	5
3	Shërbimet mjekësore dhe ndihma e parë e ofruar në institucion janë në nivelin e duhur	1	2	3	4	5

4	Hapësira që kam në vendin e punës është e mjaftueshme dhe motivuese për punë efektive	1	2	3	4	5
5	Institucioni ofron një infrastrukturë teknologjike bashkëkohore (si projektorë, kompjuterë, rrjet interneti, sistem i menaxhimit të informacionit) që lehtëson proceset administrative	1	2	3	4	5
6	Institucioni ofron mundësi të përshtatshme për shërbime sociale (si kafene, ngrënie e drekës, mjedise sportive etj.) që lehtësojnë komoditetin dhe mirëqenien gjatë orarit të punës	1	2	3	4	5
<i>Roli dhe të drejtat e personelit administrativ në institucion</i>						
7	Kam përshkrim të qartë të detyrave që më përkasin	1	2	3	4	5
8	Institucioni respekton kushtet kontraktuale lidhur me angazhimin tim	1	2	3	4	5
9	Procedurat për adresimin e ankesave janë funksionale	1	2	3	4	5
10	Drejtuesit e administratës/eporët e marrin parasysh mendimin tonë	1	2	3	4	5
11	Personeli administrativ gëzon liri në shprehjen e mendimeve dhe qëndrimeve të tij	1	2	3	4	5
12	Institucioni mbështet dhe inkurajon idetë dhe kontributet e reja nga personeli administrativ	1	2	3	4	5
13	Institucioni nxit përfshirjen e personelit administrativ në proceset vendimmarrëse	1	2	3	4	5
14	Detyrat e mia janë në përputhje me fushën time të specializimit/studimeve	1	2	3	4	5
15	Numri i personelit administrativ të institucionit është i mjaftueshëm	1	2	3	4	5
16	Jam i kënaqur me efikasitetin dhe mbështetjen që ofrojnë zyrat/njësitë administrative të njërive përkatëse	1	2	3	4	5
<i>Shërbimet dhe mbështetja administrative e institucionit</i>						
17	Institucioni më ofron mbështetjen administrative të nevojshme për përmbushjen e detyrave të mia	1	2	3	4	5
18	Institucioni ofron një mjedis pune të qëndrueshëm dhe siguri për vazhdimësinë e angazhimit tim profesional	1	2	3	4	5
19	Jam i kënaqur me atmosferën e përgjithshme të punës në institucion	1	2	3	4	5
20	Kam një bashkëpunim konstruktiv dhe të kënaqshëm me kolegët e administratës	1	2	3	4	5
21	Jam i kënaqur nga bashkëpunimi me personelin akademik të institucionit	1	2	3	4	5

22	Institucioni përdor me efikasitet ekspertizën profesionale të personelit administrativ	1	2	3	4	5
23	Institucioni inkurajon dhe mbështet pjesëmarrjen e personelit në trajnime që përmirësojnë aftësitë profesionale	1	2	3	4	5
24	Institucioni ofron mundësi të mjaftueshme trajnimesh zhvillimi profesional të personelit administrativ	1	2	3	4	5
<i>Vizioni dhe strategjia institucionale</i>						
25	Jam në dijeni për vizionin dhe misionin e institucionit	1	2	3	4	5
26	Institucioni drejtohet me profesionalizëm dhe integritet	1	2	3	4	5
27	Institucioni i kushton rëndësi të veçantë prezantimit kombëtar dhe ndërkombëtar	1	2	3	4	5
28	E shoh UMT si një institucion të qëndrueshëm ku mund të zhvilloj karrierën time profesionale afatgjatë	1	2	3	4	5
29	E sugjeroj UMT si një mundësi për zhvillimin e karrierës profesionale	1	2	3	4	5
30	E sugjeroj UMT si një nga zgjedhjet më të mira	1	2	3	4	5
31	Kushtet financiare të ofruara nga institucioni janë të kënaqshme	1	2	3	4	5
32	Institucioni inkurajon përfshirjen e personelit administrativ në zhvillimin dhe përmirësimin e strategjive të tij afatgjata	1	2	3	4	5

1. Rendisni disa nga aspektet kryesore në UMT që ju japin kënaqësi në punën tuaj.

2. Përmendni disa elemente që, sipas mendimit tuaj, do të ndihmonin në rritjen e motivimit tuaj në UMT

3. Rendisni një ose disa faktorë që mund t'ju motivojnë për të kërkuar mundësi të reja karriere jashtë UMT.

4. Sugjeroni çfarë mund të ndryshohet ose përmirësohet për të arritur një administrim më të mirë në UMT.

PYETËSOR PËR VLERËSIMIN E INSTITUCIONIT NGA STUDENTËT

I dashur student,

Ky pyetësor synon t'ju ofrojë një hapësirë për të shprehur mendimet dhe përvojën tuaj mbi studimet dhe mbështetjen që merrni në Universitetin Metropolitan Tirana (UMT), duke na ndihmuar të identifikojmë fushat ku mund të përmirësojmë më tej cilësinë e mësimdhënies dhe shërbimeve për studentët tanë.

Rezultatet e këtij pyetësori do të kontribuojnë në krijimin e një mjedisi akademik që reflekton pritshmëritë dhe nevojat e studentëve, duke nxitur një përvojë studimi të plotë dhe të kënaqshme. Përgjigjet tuaja do të trajtohen me konfidencialitet të plotë dhe do të ndihmojnë në zhvillimin e një vizioni të qartë për përmirësimin e përvojës suaj në UMT.

Ju falënderojmë për kohën, sinjeritetin dhe angazhimin tuaj për të kontribuar në zhvillimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të institucionit tonë!

Gjinia

- Femër
- Mashkull

Programi i studimit (plotëso):

Program profesional në "Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente";
Program Profesional në "Topografi dhe GIS"
Program Profesional në "Dizajn dhe Zhvillim Software";
Program Profesional në "Grafik Dizajn"
Bachelor në "Informatikë Ekonomike" (shqip)
Bachelor në "Informatike Ekonomike" (anglisht)
Bachelor në Administrim Biznesi me profile: "Menaxhim", "Marketing", "Sipërmarrje dhe Inovacion";
Bachelor në Financë me dy profile: "Kontabilitet", "FinTech";
Bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike";
Bachelor në "Inxhinieri Software" (anglisht);
Bachelor në "Inteligjencë Artificiale";
Bachelor në Inxhinieri Elektrike me profile: "Sistemet e fuqisë",
"Elektronikë", "Komunikime dixhitale", "Kontroll inxhinierik", "Makinieri elektrike";
Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi";
Program i Integruar i Nivelit të Dytë në Arkitekturë
Master i Shkencave në "Menaxhim në Inxhinieri";
Master i Shkencave në "Ekonomik – MBA";

Master i Shkencave në “Inxhinieri Financiare dhe Menaxhim Risku”
 Master i Shkencave në “Inxhinieri Informatike”;
 Master i Shkencave në “Inxhinieri Software”;
 Master në Inxhinieri Elektrike me dy profile: “Energjetikë”, “Automatizim Industrie”
 Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profile: “Inxhinieri Strukturash”,
 “Inxhinieri Infrastrukturë Transporti”;
 Master i Shkencave në “Business Analytics & Artificial Intelligence”
 Master i Shkencave në “Artificial Intelligence”
 Master Profesional në “Marketing Dixhital”;
 Doktoratë në “Inteligjenca Artificiale dhe Sistemet Inteligjente”

Vlerësoni pohimet e mëposhtme sipas shkallës nga 1 në 5, ku 1 është vlerësim minimal dhe 5 maksimal, respektivisht nga “Nuk jam aspak dakord” deri në “Jam plotësisht dakord”.

Nr.	Pohimi	Vlerësimi				
Shërbimet informative dhe administrimi i procesit të regjistrimit						
1	Jam i kënaqur me përvojën time të regjistrimit në programin e studimit që studioj	1	2	3	4	5
2	Regjistrimi i lëndëve semestrale kryhet në mënyrë të qartë dhe pa komplikime	1	2	3	4	5
3	Shërbimi për lëshimin e dokumenteve të studentit, si vërtetimet dhe transkriptet, është i shpejtë dhe efikas	1	2	3	4	5
4	Faqja e internetit e institucionit ofron informacion të mjaftueshëm mbi orarin mësimor, regjistrimet dhe aktivitetet akademike e sociale	1	2	3	4	5
Infrastruktura teknologjike dhe mjediset fizike						
5	Higjiena dhe pastërtia e ambienteve të përbashkëta të institucionit (tualet, korridore dhe klasa) është e kënaqshme	1	2	3	4	5
6	Klasat dhe mjediset laboratorike ofrojnë hapësirë të mjaftueshme dhe një ambient të përshtatshëm për mësim efektiv	1	2	3	4	5
7	Infrastruktura teknologjike e UMT (internet, tabela interaktive, kompjuterët, etj.) plotëson nevojat e mia si student	1	2	3	4	5
8	Jam i kënaqur me burimet dhe shërbimet që ofron biblioteka për mbështetjen e studimeve të mia					
Cilësia Akademike dhe Mësimdhënia						
9	Programi i studimit që kam zgjedhur përputhet me interesat dhe objektivat e mia akademike	1	2	3	4	5
10	Mendoj se ka një raport të përshtatshëm midis numrit të pedagogëve dhe numrit të studentëve	1	2	3	4	5

11	Pedagogët janë të gatshëm të japin mbështetje shtesë jashtë orarit të mësimit kur kam pyetje ose kam nevojë për ndihmë akademike	1	2	3	4	5
12	Procesi i këshillimit akademik siguron mbështetjen e nevojshme për përparimin tim akademik	1	2	3	4	5
13	Komunikimi me administratën dhe pedagogët është i strukturuar dhe i shpejtë	1	2	3	4	5
14	Institucioni organizon aktivitete jashtë kurrikulare që më ndihmojnë në zhvillimin tim profesional	1	2	3	4	5
15	Programi ofron mundësi të vlefshme për praktika profesionale që më ndihmojnë të fitoj përvojë reale pune	1	2	3	4	5
<i>Përgatitja profesionale dhe avantazhet konkurruese</i>						
16	Jam i kënaqur që kam zgjedhur UMT si institucionin tim të studimeve	1	2	3	4	5
17	Kushtet e ofruara në UMT kanë tejkaluar pritshmëritë e mia fillestare	1	2	3	4	5
18	Aftësitë në gjuhë të huaja të fituara në këtë institucion përbëjnë një avantazh profesional për karrierën time	1	2	3	4	5
19	Tarifat financiare të programit janë të arsyeshme dhe të përballueshme për mua	1	2	3	4	5
<i>Jeta sociale dhe mjedisi studentor</i>						
20	Institucioni ofron mjedise sociale që kontribuojnë pozitivisht në jetën time studentore	1	2	3	4	5
21	Institucioni zhvillon aktivitete sociale dhe kulturore që e pasurojnë përvojën time studentore	1	2	3	4	5
22	Përgjatë vitit akademik, institucioni zhvillon aktivitete që promovojnë diversitetin dhe përfshirjen sociale midis studentëve	1	2	3	4	5
23	Jam i kënaqur nga shërbimet mjekësore	1	2	3	4	5
<i>Pjesëmarrja studentore dhe përfaqësimi</i>						
24	Studentët janë të përfaqësuar në organet kolegjiale të institucionit	1	2	3	4	5
25	Institucioni nxit kërkesat e përfaqësuesve të studentëve dhe është i hapur për sugjerimet e tyre	1	2	3	4	5
<i>Ndjenja e përkatësisë dhe implikimet për të ardhmen</i>						
26	Diploma e UMT më bën të ndihem krenar dhe të sigurt për të ardhmen time profesionale	1	2	3	4	5
27	Ndihem krenar kur u them të tjerëve se studioj në UMT					
28	UMT është universiteti ku shoh mundësinë për të përfunduar studimet në të gjitha nivelet akademike					
29	E sugjeroj UMT si një nga zgjedhjet më të mira					
30	Sugjeroj UMT për ata që kërkojnë një edukim cilësor dhe mundësi të shkëlqyera zhvillimi					

- 1. Bëni komente/sugjerimet tuaja se çfarë mund të bëjmë ndryshe për një administrim më të mirë të institucionit**

FORMULAR PËR VLERËSIMIN E PËRVOJËS SË STUDENTËVE TË VITIT TË PARË NË UMT

(Të plotësohet në javën e shtatë të semestrit të parë)

I nderuar student,

Në kuadër të sigurimit të cilësisë, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në Universitetin Metropolitan Tirana (UMT) po realizon këtë pyetësor për të vlerësuar përvojën tuaj si student i vitit të parë. Pyetësori synon të mbledhë opinione mbi procesin e regjistrimit, pritshmëritë dhe eksperiencën tuaj gjatë periudhës së parë të studimeve në UMT. Të dhënat tuaja do të jenë anonime dhe do të përdoren vetëm për qëllime përmirësimi institucional.

Ju falënderojmë për kohën dhe kontributin tuaj!

I. TË DHËNA DEMOGRAFIKE

1. Gjinia:

Mashkull

Femër

2. Programi i studimit: (Ju lutemi, zgjidhni një opsion nga lista më poshtë.)

Lista e programeve të UMT

3. Qyteti nga vini:

Përgjigje e hapur

4. Shkolla e mesme që keni mbaruar:

Përgjigje e hapur

II. PRITSHMËRITË DHE EKSPERIENCAT E PARA

1. Si keni dëgjuar për UMT? (Mund të zgjidhni më shumë se një alternativë):

- ☐ Nga studentët aktualë të UMT
- ☐ Nga prindërit ose të afërmit
- ☐ Nga pedagogët e UMT
- ☐ Nga mësuesit e shkollës së mesme
- ☐ Nga shokët/shoqet
- ☐ Nga mediat (TV, website, Instagram, Facebook, etj.)
- ☐ Nga panaire ose prezantime të organizuara nga UMT
- ☐ Tjetër (ju lutemi specifikoni): _____

2. Cili/cilët faktorë ndikuan në zgjedhjen e programit tuaj të studimeve në UMT?

(Mund të zgjidhni më shumë se një alternativë)

- ☐ Emërtimi dhe cilësia akademike e programit të studimeve
- ☐ Tarifat konkurruese të studimeve
- ☐ Reputacioni pozitiv i UMT në tregun akademik
- ☐ Eksperienca dhe përkushtimi i pedagogëve të UMT
- ☐ Rekomandimet nga prindërit ose të afërmit
- ☐ Afërsia e universitetit me vendin e banimit tim
- ☐ Rekomandimet nga miqtë ose ish-studentët e UMT
- ☐ Fushatat promovuese të UMT në media (TV, internet, rrjete sociale, etj.)
- ☐ Tjetër (ju lutemi specifikoni): _____

3. Informacioni i ofruar nga UMT, përmes mediave dhe stafit të institucionit, përputhet me pritshmëritë e mia dhe përvojën reale që kam pasur si student në këtë universitet.

Ju lutemi, vlerësoni shkallën tuaj të dakordësisë me këtë pohim duke përdorur shkallën më poshtë:

- ☐ 1 – Plotësisht kundër
- ☐ 2 - Kundër
- ☐ 3 - Neutral
- ☐ 4 - Dakord
- ☐ 5 - Plotësisht dakord

4. Pritshmëritë e mia para regjistrimit përputhen me përvojën aktuale si student në UMT.

- ☐ 1 – Plotësisht kundër
- ☐ 2 - Kundër
- ☐ 3 - Neutral
- ☐ 4 - Dakord
- ☐ 5 - Plotësisht dakord

III. VLERËSIMI I INFRASTRUKTURËS DHE SHËRBIMEVE

Ju lutemi të vlerësoni secilin prej pohimeve të mëposhtme duke përdorur shkallën nga 1 në 5, ku 1 është vlerësim minimal dhe 5 maksimal, respektivisht ‘Nuk pajtohem aspak’, ‘Nuk pajtohem’, ‘Jam neutral’, ‘Pajtohem’, ‘Pajtohem plotësisht’.

Nr.	Pohimi	Vlerësimi
-----	--------	-----------

1	Procesi i orientimit për studentët e rinj ishte i qartë dhe i dobishëm për të kuptuar mënyrën e funksionimit të universitetit	1	2	3	4	5
2	Procesi i regjistrimit në UMT ishte i thjeshtë, i qartë dhe pa pengesa	1	2	3	4	5
3	Platforma online (Edu4School) e UMT për informacione akademike dhe regjistrimin e lëndëve është e lehtë për t'u përdorur dhe e dobishme	1	2	3	4	5
4	Jam informuar qartë mbi të drejtat dhe detyrimet e mia si student në UMT	1	2	3	4	5
5	Rregulloret dhe politikat e universitetit janë të qarta dhe të lehta për t'u ndjekur	1	2	3	4	5
6	Kam marrë udhëzime të mjaftueshme për përdorimin e platformave teknologjike të universitetit	1	2	3	4	5
7	Infrastruktura teknologjike e UMT, (Wi-Fi, kompjuterë, laboratorë, etj.) përmbush nevojat e studentëve	1	2	3	4	5
8	Orari i leksioneve dhe seminareve është i përshtatshëm dhe i lehtë për t'u ndjekur	1	2	3	4	5
9	Pastërtia dhe mirëmbajtja e ambienteve të UMT janë në nivel të kënaqshëm	1	2	3	4	5
10	Cilësia e mësimdhënies në UMT përmbush pritshmëritë e mia si student	1	2	3	4	5
Shërbimet akademike dhe administrative						
11	Sekretaria mësimore është efikase dhe e gatshme për të ndihmuar studentët	1	2	3	4	5
12	Koordinatori i fakultetit ofron mbështetje dhe udhëzime të dobishme për studentët	1	2	3	4	5
13	Këshillimi akademik është i dobishëm dhe ndihmon në planifikimin e studimeve	1	2	3	4	5
14	Procesi i regjistrimit të lëndëve është i qartë dhe i lehtë për t'u ndjekur	1	2	3	4	5
Njohja me mundësitë jashtë kurrikulës						
15	Jam informuar rreth klubeve studentore dhe aktiviteteve jashtë mësimore që ofron UMT	1	2	3	4	5
16	Aktivitetet e organizuara nga dekanati i studentëve janë tërheqëse dhe të dobishme për integrimin universitar	1	2	3	4	5
17	Kam marrë informacion të qartë për mundësitë e këshillimit për karrierë në UMT	1	2	3	4	5
18	Mjedisi social në UMT më inkurajon të ndërtoj marrëdhënie dhe të përfshihem në aktivitete jashtë mësimore					

IV. KOMENTE SHITESË

A keni ndonjë koment apo sugjerim për të përmirësuar përvojën tuaj në UMT?

Plotëso:

FORMULAR PËR VLERËSIMIN E REKTORIT NGA SENATI AKADEMIK

(Të plotësohet në fund të çdo viti akademik)

Ky pyetësor ka për qëllim vlerësimin e performancës së Rektorit nga anëtarët e Senatit Akademik të Universitetit Metropolitan Tirana (UMT). Vlerësimi do të ndihmojë në analizimin e efektivitetit të drejtimit akademik dhe menaxhimit institucional. Të dhënat e mbledhura do të trajtohen me konfidencialitet të plotë dhe do të përdoren vetëm për përmirësimin e lidershit akademik.

Ju falënderojmë për kontributin tuaj!

Periudha e vlerësimit : _____

Ju lutemi të vlerësoni secilin prej pohimeve të mëposhtme duke përdorur shkallën nga 1 në 5, ku 1 është vlerësim minimal dhe 5 maksimal, respektivisht ‘Nuk pajtohem aspak’, ‘Nuk pajtohem’, ‘Jam neutral’, ‘Pajtohem’, ‘Pajtohem plotësisht’.

Nr.	Pohimi	Vlerësimi				
Drejtimi akademik dhe lidershipi						
1	Rektori drejton me profesionalizëm dhe integritet Senatin Akademik dhe siguron funksionimin efektiv të tij	1	2	3	4	5
2	Siguron një vizion strategjik të qartë dhe efektiv për zhvillimin akademik dhe administrativ të universitetit	1	2	3	4	5
3	Respekton autonominë akademike dhe angazhohet në mbrojtjen e parimeve akademike dhe etike	1	2	3	4	5
4	Mbështet dhe promovon inovacionin dhe ekselencën akademike	1	2	3	4	5
5	Krijon një mjedis akademik që nxit cilësinë e arsimit dhe kërkimit shkencor	1	2	3	4	5
Menaxhimi institucional dhe transparenca						
6	Rektori harton dhe zbaton strategji të qarta për zhvillimin afatgjatë akademik dhe administrativ të universitetit	1	2	3	4	5
7	Siguron transparencë dhe llogaridhënie në proceset e menaxhimit të universitetit	1	2	3	4	5
8	Garanton që vendimmarrjet e universitetit janë në përputhje me statutin, rregulloret dhe kornizën ligjore në fuqi.	1	2	3	4	5
9	Përfshin Senatin Akademik në vendimmarrjet kryesore për zhvillimin e universitetit	1	2	3	4	5
Marrëdhënia me stafin akademik dhe studentët						
10	Rektori angazhohet për të krijuar një klimë bashkëpunimi dhe respekti me stafin akademik	1	2	3	4	5
11	Mban komunikim të hapur dhe konstruktiv me Senatin Akademik dhe njësitë akademike	1	2	3	4	5

12	Siguron pjesëmarrjen e studentëve në proceset vendimmarrëse të universitetit	1	2	3	4	5
13	Promovon politika që mbështesin zhvillimin profesional të stafit akademik	1	2	3	4	5
14	Siguron një qasje të balancuar dhe të drejtë ndaj nevojave dhe interesave të palëve të ndryshme	1	2	3	4	5
<i>Menaxhimi i burimeve dhe efektiviteti administrativ</i>						
15	Rektori nënshkruan dhe menaxhon kontratat e punës të stafit akademik dhe ndihmës akademik me përgjegjshmëri	1	2	3	4	5
16	Siguron një shfrytëzim efektiv të burimeve financiare dhe infrastrukturore të universitetit	1	2	3	4	5
17	Përmbush përgjegjësitë ligjore dhe statutore në drejtimin e institucionit	1	2	3	4	5
18	Garanton një proces të drejtë dhe meritokratik në rekrutimin dhe promovimin e stafit akademik	1	2	3	4	5
19	Mbikëqyr dhe zbaton masa efektive për sigurimin e cilësisë së arsimit dhe akreditimin institucional	1	2	3	4	5
<i>Kultura institucionale dhe etika akademike</i>						
20	Rektori promovon një kulturë akademike të bazuar në meritokraci, transparencë dhe integritet	1	2	3	4	5
21	garanton zbatimin e parimeve të etikës akademike dhe qeverisjes së mirë	1	2	3	4	5
22	Inkurajon një mjedis akademik të hapur, gjithëpërfshirës dhe me respekt ndaj diversitetit të mendimeve	1	2	3	4	5
23	Stimulon frymën e bashkëpunimit dhe ndan përgjegjësitë në mënyrë të drejtë dhe transparente	1	2	3	4	5

Ju lutemi të jepni sugjerimet, komentet ose vlerësimet tuaja të tjera në lidhje me performancën e Rektorit dhe aspektet që mund të përmirësohen:

FORMULAR PËR VLERËSIMIN E ZËVENDËSREKTORIT/ËVE NGA ANËTARËT E SENATIT AKADEMIK

(Të plotësohet në fund të çdo viti akademik)

Ky pyetësor ka për qëllim vlerësimin e performancës së Zëvendësrektorit/ëve nga anëtarët e stafit akademik të Universitetit Metropolitan Tirana (UMT). Vlerësimi do të ndihmojë në analizimin e efektivitetit të tij në drejtimin akademik dhe administrativ, si dhe në identifikimin e fushave për përmirësim. Të dhënat e mbledhura do të trajtohen me konfidencialitet të plotë dhe do të përdoren vetëm për përmirësimin e lidërshiptit akademik.

Ju falënderojmë për kontributin tuaj!

Zëvendësrektori që vlerësohet	
Fusha që mbulon	
Periudha e vlerësimit	

Ju lutemi të vlerësoni secilin prej pohimeve të mëposhtme duke përdorur shkallën nga 1 në 5, ku 1 është vlerësim minimal dhe 5 maksimal, respektivisht ‘Nuk pajtohem aspak’, ‘Nuk pajtohem’, ‘Jam neutral’, ‘Pajtohem’, ‘Pajtohem plotësisht’.

Nr.	Pohimi	Vlerësimi				
I. Drejtimi akademik dhe përputhshmëria me objektivat institucionale						
1	Zëvendësrektori kryen funksionin e tij në përputhje me misionin dhe objektivat e universitetit	1	2	3	4	5
2	Zbaton me përpikëri dhe profesionalizëm detyrat e deleguara nga Rektori	1	2	3	4	5
3	Monitoron dhe mbështet zbatimin e politikave akademike dhe kërkimore në përputhje me objektivat e universitetit	1	2	3	4	5
4	Siguron që strategjitë akademike dhe administrative të ndjekin standardet e cilësisë institucionale	1	2	3	4	5
5	Nxit zhvillimin dhe përmirësimin e fushës së tij të përgjegjësisë (kërkimi shkencor, projektet, marrëdhëniet me jashtë, etj.)	1	2	3	4	5
II. Lidërshipi dhe vendimmarrja						
6	Zëvendësrektori demonstroi aftësi të forta në vendimmarrje dhe menaxhimin e sfidave institucionale	1	2	3	4	5
7	Përfaqëson denjësisht Rektoren në mungesë të tij, për funksionet që i janë deleguar	1	2	3	4	5
8	Ka aftësi të mira komunikimi dhe koordinimi me njësitë akademike dhe administrative	1	2	3	4	5
9	Ofron udhëheqje të qartë dhe mbështet bashkëpunimin mes njësive akademike	1	2	3	4	5
10	Siguron koordinim efektiv për të përmirësuar rezultatet në fushën e tij të përgjegjësisë	1	2	3	4	5

III. Menaxhimi i burimeve dhe efektiviteti administrativ						
11	Zëvendësrektori siguron një shfrytëzim efektiv të burimeve akademike dhe administrative në fushën e tij të përgjegjësisë	1	2	3	4	5
12	Mbështet një menaxhim të përgjegjshëm dhe transparent të fondeve dhe projekteve akademike	1	2	3	4	5
13	Promovon përdorimin e teknologjisë dhe metodave inovative për përmirësimin e mësimdhënies, kërkimit dhe administrimit akademik	1	2	3	4	5
14	Angazhohet për të siguruar që procedurat administrative mbështesin zhvillimin akademik të universitetit	1	2	3	4	5
15	Monitoron zbatimin e standardeve të akreditimit dhe cilësisë në fushën e tij të përgjegjësisë	1	2	3	4	5
IV. Kultura institucionale dhe etika akademike						
16	Zëvendësrektori promovon një kulturë akademike të bazuar në meritokraci, transparencë dhe integritet	1	2	3	4	5
17	Siguron një mjedis akademik gjithëpërfshirës, të hapur dhe me respekt për diversitetin e mendimeve	1	2	3	4	5
18	Stimulon frymën e bashkëpunimit dhe ndan përgjegjësitë në mënyrë të drejtë dhe transparente	1	2	3	4	5
19	Vepron në përputhje me standardet e etikës dhe integritetit në menaxhimin akademik dhe administrativ	1	2	3	4	5
20	Mbështet zhvillimin e projekteve dhe bashkëpunimeve akademike brenda dhe jashtë institucionit	1	2	3	4	5

Ju lutemi të jepni sugjerimet, komentet ose vlerësimet tuaja të tjera në lidhje me performancën e Zëvendësrektorit dhe aspektet që mund të përmirësohen:

FORMULAR PËR VETËVLERËSIMIN E ZËVENDËSREKTORIT/ËVE

(Të plotësohet në fund të çdo viti akademik)

Ky formular synon të ndihmojë Zëvendësrektorin të reflektojë mbi performancën e tij gjatë vitit akademik. Vetëvlerësimi shërben si një mjet për identifikimin e arritjeve, sfidave dhe fushave që mund të përmirësohen. Të dhënat do të trajtohen me konfidencialitet dhe do të përdoren për zhvillimin profesional dhe institucional.

Ju falënderojmë për kontributin tuaj!

Zëvendësrektori që vetëvlerësohet	
Fusha që mbulon	
Periudha e vlerësimit	

Ju lutemi të vlerësoni secilin prej pohimeve të mëposhtme duke përdorur shkallën nga 1 në 5, ku 1 është vlerësim minimal dhe 5 maksimal, respektivisht ‘Nuk pajtohem aspak’, ‘Nuk pajtohem’, ‘Jam neutral’, ‘Pajtohem’, ‘Pajtohem plotësisht’.

Nr.	Pohimi	Vlerësimi				
I. Përputhshmëria me objektivat institucionale						
1	Si zëvendësrektor, kam zbatuar detyrat e mia në përputhje me strategjinë dhe objektivat e universitetit	1	2	3	4	5
2	Kam kontribuar në zhvillimin akademik dhe administrativ të universitetit	1	2	3	4	5
3	Kam identifikuar dhe zbatuar strategji për përmirësimin e fushës sime të përgjegjësisë	1	2	3	4	5
4	Kam adresuar sfidat dhe problematikat institucionale në mënyrë efektive	1	2	3	4	5
5	Kam siguruar përputhshmërinë me rregulloret dhe standardet e cilësisë institucionale	1	2	3	4	5
II. Lidershipi dhe vendimmarrja						
6	Kam marrë vendime të informuara dhe të bazuara në analiza institucionale	1	2	3	4	5
7	Kam demonstruar lidership efektiv në drejtimin e njësive akademike dhe administrimit të projekteve	1	2	3	4	5
8	Kam ndihmuar në motivimin dhe zhvillimin profesional të stafit akademik dhe administrativ	1	2	3	4	5

9	Kam menaxhuar me sukses situatat sfiduese dhe problematikat institucionale	1	2	3	4	5
10	Kam përfaqësuar universitetin në përputhje me pritshmëritë institucionale					
III. Menaxhimi i burimeve dhe efektiviteti administrativ						
11	Kam siguruar menaxhim të përgjegjshëm dhe transparent të burimeve akademike dhe financiare	1	2	3	4	5
12	Kam promovuar përdorimin e teknologjisë dhe metodave inovative në procesin akademik	1	2	3	4	5
13	Kam ndihmuar në optimizimin e procedurave administrative për të mbështetur misionin akademik	1	2	3	4	5
14	Kam siguruar që aktivitetet e fushës sime janë zhvilluar në përputhje me kërkesat ligjore dhe institucionale	1	2	3	4	5
15	Kam monitoruar dhe zbatuar masa për përmirësimin e standardeve të akreditimit dhe cilësisë	1	2	3	4	5
IV. Kontributi në projekte, kërkim dhe marrëdhënie institucionale						
16	Kam udhëhequr ose mbështetur projekte dhe iniciativa akademike me ndikim institucional	1	2	3	4	5
17	Kam ndihmuar në zgjerimin e bashkëpunimeve akademike dhe ndërkombëtare të universitetit	1	2	3	4	5
18	Kam nxitur dhe mbështetur kërkimin shkencor dhe përfshirjen e stafit në projekte shkencore	1	2	3	4	5
19	Kam kontribuar në rritjen e imazhit të universitetit përmes përfaqësimit institucional	1	2	3	4	5
20	Kam promovuar dhe mbështetur zhvillimin e kapaciteteve kërkimore dhe akademike	1	2	3	4	5
V. Kultura institucionale dhe etika akademike						
